

Nr 1826/1 prot  
15.03.2022



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI I QARKUT FIER  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 244/ Prot.

Fier, më 11.03.2022

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 15, dhe Nr. 16, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 28.02.2022.

**BASHKISË ROSKOVEC**  
**KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC**

**Roskovec**

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 1826 prot. datë 01.03.2022, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 244 prot. datë 04.03.2022, bazuar në ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" neni 16 si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen datës 28.02.2022, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 2, datë 28.02.2021, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 547, prot. datë 25.01.2022, procesverbalet e këshillimit publik si dhe dokumentacionin plotësues të vendimeve, shprehemi si më poshtë:

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 15, datë 28.02.2022, "Për miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij"**, shoqëruar nga projekt-vendimi Nr. 15, datë 21.02.2022, protokolluar me Nr. 1536 prot. datë 21.01.2022, relacioni shpjegues Nr. 1536/1 prot. datë 21.01.2022, procesverbalet e këshillimit publik Nr. 3, datë 17.02.2022 dhe Nr. 4, datë 17.02.2022, të mbajtur në librin e dëgjësive publike me Nr. 437 prot. datë 21.01.2022, Është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 18 pika 1, neni 54 shkronja "k" dhe ligjin Nr. 75/2019 "Për rininë" neni 10, pika 3.

**Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 16, datë 28.02.2022, "Për miratim fonde shtesë dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022"**, shoqëruar nga projekt vendimi Nr. 16, datë 21.02.2022, protokolluar me Nr. 1534 prot. datë 21.01.2022, relacioni shpjegues Nr. 1534/1 prot. datë 21.01.2022, Është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b", neni 54 gërma "dh", ligjin Nr. 68/2017 "Për

Financat e vetëqeverisjes vendore” neni 10, neni 45, ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 15, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 103.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**PREFEKTI**  
**Lefter Shehaj**

